



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.368/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rafet Haxhaj dhe Zyhdi Haziri anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Mentor Berisha nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, paraqitur kundër Këshillit të Vendvotimit (KVV), në Obiliq, për shkak të parregullsive në Vendvotim, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET si e palejuar** ankesa ZL.Anr.368/2017 e datës 23.10.2017 e Mentor Berishës nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Obiliq.

## A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 23.10.2017 nga Mentor Berisha nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Obiliq, me të cilën pretendon se ka dyshime se në VV-të: 1502E/01R, 02R, 03R, në Obiliq ka pasur parregullsi.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### **Ankesa është e pa lejuar**

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesën përkitazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ta hedh si të palejuar ankesën e ankuesit. Hedhja e ankesës të ankuesit nuk e paragjykon çështjen se ankuesit i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.


Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Zl.Anr. 368/2017 me datën 24.10.2017.

**Kryesuesi i Paneli**

**Faton Ademi**



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-***